



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.183, Datë 10.09.2021

MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SH.P.K., PËR TRANSFERIMIN E
ASETEVE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika “a”, nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikat 1.3 dhe 1.6, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.09.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.118/2 prot, datë 03.09.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k., për transferimin e asetëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 839 prot., datë 21.07.2021, ka paraqitur kërkesën për transferimin e asetëve.
- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 112, Seria PV10K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe licencës nr. 113, Seria T10P, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Kërkesa e shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k. nuk është shoqëruar me asnjë dokumentacion sipas legjislacionit në fuqi, ç’ka bën të pamundur marrjen e saj në shqyrtim nga ERE.
- Për nevoja të aplikimit për transferim asetesh, nga ana e shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k. bashkëlidhur kërkesës duhet të përcillet edhe i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga neni 7, i “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve të të licencuarve” si dhe vlera e asetëve fikse që kërkon të transferojë, duke qenë se ERE në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, shprehet vetëm për asetet fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k. për transferim të aseteve.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI